

ATK për Studentët, Studentët për ATK-në

Konkurs për dizajnimin e logos

Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) u bën thirrje të gjithë të interesuarve, e në veçanti studentëve të dizajnit grafik dhe studentëve të tjerë që të aplikojnë në konkursin për dizajnimin e logos së ATK-së.

Konkursi është i natyrës garues dhe tre idetë më të mira do të shpërblehen: vendi i parë me 600 Euro, vendi i dytë me 250 Euro dhe vendi i tretë me 140 Euro.

ATK do të ketë ekskluzivitetin për përdorimin e ideve fituese (logove fituese), ndërsa vlerësimi do të bëhet nga komiteti menaxhues i ATK-së i përbërë edhe nga një ekspert i dizajnit dhe atë në bazë të kritereve të poshtëshënuara:

- Kuptimplotë - të shprehë detyrat dhe obligimet e ATK-së
- E thjeshtë - e pastër dhe jo e komplikuar
- Reflektive – të reflektoj vizionin dhe misionin e ATK-së
- E dukshme - e lehtë për tu dalluar dhe për tu mbajtur në mend
- Praktike – të mund të përdoret në të gjitha materialet e ATK-së
- E veçantë - të mos jetë e kopjuar nga logot e institucioneve, kompanive apo ndonjë entiteti tjetër
- Ngjyra - të anoj në niansat e ngjyrave kaltërt dhe hiri, mirëpo mos të kufizohet në to
- E qëndrueshme – të jetë bashkëkohore dhe jetëgjatë
- Në rast të përdorimit të inicialeve të përdoren inicialet për të gjitha gjuhët zyrtare të Kosovës

Për të aplikuar drejtohuni në adresën prokurimi@atk-ks.org dhe kërkonte dosjen tenderike. Pasi të plotësoni këtë dosje, bashkangjiteni propozimin tuaj, futeni në zarf dhe silleni në zyret qendrore të ATK-së në adresën: Këndi i Rrugëve Dëshmorët e Kombit dhe Bill Clinton; 10 000 Prishtinë, Kosovë *deri me datën 27 Dhjetor 2010 ora 14:00.*

Ju faleminderit që paguani tatimet dhe ndihmoni në zhvillimin ekonomik të vendit tonë!

Me respekt,
Administrata Tatimore e Kosovës